



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2175 Prot

Gjirokastrë më 5 : 3 : 2025

Lënda: Procesverbal I mbledhjes së datës 28.02.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 28.02.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 28.02.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:14

Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Feruni, Aliko, Cacaj, Eri Shehaj, Peta, Manjola Shehaj, Rova, Leskaj, Pandos, Çuçani, Drasa, Mahmutaj, Muho. Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.01.2025 dhe 14.02.2025.

2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-28.02. 2025”.

3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin .01.02 2025-28.02.2025”.

4. P.Vendim “Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore /dimërore që do të kontraktohen për përdorimin me qira për kullotje për sezonin veror 2025 dhe sezonin dimëror 2025-2026”. 9 I rikthyer nga Prefekti I Qarkut për heqjen nga lista të parcelave kullosore të rikthyera ish pronarëve.

5. P/Vendim “Për miratimin e dhënies së mandatit së znj. Anna Harallamb Padhimetri.

6. P/Vendim “Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Hadër Bozgo” (pas vdekjes).

7. P/Vendim “Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për ambasadorin e Spanjës në vendin tonë, z. Alvara Renedo Zalba”.

Tre pika shtesë të propozuara nga ekzekutivi.

1. P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit n për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Sistemim Asfaltim rruga “Taroninë-Zhulat” Loti 1”(I risjellë nga ekzekutivi) 2. P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit “Rikonstruksion i rrugës rreth Pallatit të Sportit Gjirokastrë.(I risjellë nga ekzekutivi) Të dyja këto matëriale kanë ardhur pa ndryshime në nr pasurie dhe në vlera por me ndryshimin e vetëm që janë hequr emrat për ti dhënë karakter normative vendimeve. 3. P/Vendim “Për dhënien e kompesimit financiar familjes së zotit .Vasil Kristidhi, si rezultat I dëmtimit të banesës së tij private për shkak të rëniës së zjarrit në banesë”.

Propozohet që pika 5 'Për dhënien e mandatit të znj. Anna Harallamb Papadimitri' të kalojë e para. Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro rendi I dites me tre pikat shtese.

Znj. Orgesa Haska flet pas shqyrtimit të materialeve të ardhura nga kqz, për dhënien e mandatit të këshilltarit.

Pas kthimit të përgjigjes nga KQZ për konfirmimin e mandatit të znj. Anna Papadimitri dhe vendimit nr.63, datë 11.02.2025 "Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë nga lista shumëëmërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë znj. Anna Harallamb Papadimitri".

Hidhe në votë dhe miratohet me 16 vota pro p/ vendimi për dhënien e mandatit të znj. Anna Harallamb Papadimitri".

Lexohet formula e betimit nga znja Isaraj dhe znj. Papadimitri pas betimit vazhdon të jetë pjesëtare në mbledhje me të drejta sit ë gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit.

Hidhen në vote dhe miratohen me 17 vota pro dy procesverbalet e mbledhjeve të datës 31.01.2025 dhe 14.02.2025 .

Hidhen në vote dhe miratohen me 17 vota pro 2 p/vendimet e ndihmës ekonomike për muajin shkurt, 6% dhe fondi i bashkisë.

Hidhet në votë pika 4 P/Vendim " Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore për vitin 2025 dhe dimërore 2025-2026" dhe miratohet me 17 vota pro.

Diskutohen 2 pikat për titujt e nderit.

Znj.Mimoza Cabeli shprehet në emër të Komisionit të Arsimit , Kulturës se komisioni ka shqyrtuar materialin dhe është shprehur dakort për kalimin e tyre në mbledhjen e këshillit.

Z. Brahimi: Jam dakord për të dyja dhe për z. Hadër Bozgo jemi të vonuar, persoalitet në fushën e arsimit dhe ka kontribuar shumë kundër analfabetizmit në vitet pas clirimit të vendit.

Hidhet në votë pika 6 P/Vendim "Për dhënien e titullit qytetar nderi për z. Hadër Bozgo pas vdekjes" dhe miratohet me 17 vota pro.

ZNJ. Isaraj:Jemi të nderuar për titullin që po propozohet sot për ambasadorin e Spanjës për promovimin që I ka bërë Gjirokastrës dhe për Universitetin e UNEDI –t në Gjirokastrë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim "Për dhënien e titullit " Qytetar Nderi" për zotin Alvaro Renedo Zalba.

Znj.Isaraj paraqet dy pikat e para shtesë të risjella nga ekzekutivi për t ju dhënë karakter normativ. Materialet nuk janë rikaluar në komision pasi nuk ka ndryshime nga hera e kaluar në nr pasurie dhe në vlera, por janë hequr vetem emrat nga tabela.Hidhen në votë dhe miratohen me 17 vota pro dy pikat e para shtesë.

1.P/Vendim"Për shprehjen e pëlqimit n për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit "Sistemim Asfaltim rruga "Taroninë-Zhulat" Loti I"(I risjellë nga ekzekutivi)

2.P/Vendim "Për shprehjen e pëlqimit për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit "Rikonstruksion i rrugës rreth Pallatit të Sportit Gjirokastrë.(I risjellë nga ekzekutivi)

z. Brahimi: Pse s po vazhdon puna? Janë hequr makineritë sapo filluan. Kam informacion nga banorët.

Znj. Lelaj:Janë mbyllur fazat ligjore, leja e ndërtimit, mbikqyrja dhe firma ka grafik punimesh.

Kalohet te pika e tretë shtesë: P/Vendim "Për dhënien e kompesimit financiar për familjen e z. Kristidhi, si rezultat i dëmtimit të banesës tij private për shkak të rënies së zjarrit".

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro.

Lexohet kërkesa e një grupi banorësh nga fshati Kolonjë në të cilën ka rrezik për rrëshqitje.

Propozohet që të ngrihet një grup pune dhe të kthehet përgjigje në Këshill në mbledhjen e ardhshme.

Mbyllet mbledhja nga znj Isaraj.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

